



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:042060

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05572392

KE.nr.6/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit Hugo Boss Trade Mark Managment GmbH & Co. KG, me seli në Gjermani, të cilin e përfaqëson Apolona Sylja avokate nga Prishtina, kundër të paditurit “MEGKOS TRANS” SH.P.K., me NUI: 811908518, me seli në rrugën “Vasil Andoni” nr.17, Prishtinë, me objekt kontesti Shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 28.03.2024, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 11.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Hugo Boss Trade Mark Managment GmbH & Co. KG dhe VËRTETOHET se i padituri “MEGKOS TRANS” SH.P.K., me datën 05.12.2022 me importimin e 55 palë jakne, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit “HUGO BOSS”, “HUGO HUGO BOSS”, “BOSS HUGO BOSS” dhe “BOSS”.
- II. I NDALOHET të paditurit që në të ardhmen të ndërmarrë qfarëdo veprimi me të cilin mund të shkelen të drejtat e pronësisë intelektuale të paditësit, në çfarëdo mënyre, përfshirë importimin, ruajtjen, ofrimin për shitje, shitjen apo shpërndarjen tjetër të mallit, që përmbajnë elemente identike apo të ngjajshme me markat tregtare të regjistruar të paditësit.
- III. OBLIGOHET i padituri që me shpenzimet e tij të shkatërroj të gjitha mallrat si në pikën I të dispozitivit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme.
- IV. OBLIGOHET i padituri që të mbuloj të gjitha shpenzimet e magazinimit të mallrave si në pikën I të dispozitivit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme.

- V. OBLIGOHET i padituri që me shpenzime të tij ta publikoj këtë aktgjykim në dy medime të Kosovës, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbushjes së detyrueshme.
- VI. OBLIGOHET i padituri që ti ofroj paditësit informacionet për furnizuesit e mallrave të cekura si në pikën I të dispozitivit, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- VII. MBETET në fuqi masa siguruese e lëshuar me aktvendimin KE.nr. 6/2023 të datës 13.04.2023, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.
- VIII. DETYROHET i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 868 € (tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Hugo Boss Trade Mark Managment GmbH & Co. KG me seli në Gjermani, përmes të autorizuarës së tij, me datën 05.01.2023, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, ka paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare dhe propozim për caktimin e masës së sigurimit, kundër të paditurit “MEGKOS TRANS” SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe të vërtetohet se i padituri duke tentuar importimin e 55 palë jakne, ka shkelur të drejtat e markave tregtare të të paditësit nr. 8723, 23456, 23457, 23458, 29382, 29383 dhe 29879, të cilat janë sekuestruar nga Dogana e Kosovës sipas njoftimit të Drejtorisë së Doganave të Kosovës, Seksioni i Pronësisë Intelektuale Nr.581/2022 të datës 5 dhjetor 2022, si dhe të i ndalohet të paditurit, çdo aktivitet i cili shkel markat tregtare të paditësit, në veçanti importi, eksporti, deponimi dhe vendosja në treg i mallrave të lartcekura, të obligohet i padituri që të shkatërroj mallrat kontestuese, si dhe t’i mbulojë shpenzimet e magazinimit të bëra nga data kur mallrat kontestuese janë sekuestruar nga Dogana e Kosovës, si dhe t’i ofroj paditësit detajet e plota të furnizuesit të huaj të mallrave kontestuese, me publikimin e këtij aktgjykimi me shpenzime të paditurit në gazetën ditore KOHA DITORE, brenda 15 ditëve nga data kur vendimi behet përfundimtar dhe i ekzekutueshëm si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e paditësit, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës duke theksuar që janë ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar që mallrat e sekuestruara janë mallra të falsifikuara. Ka shtuar që i

padituri ka importuar në Kosovë artikuj të ndryshëm veshjesh të shënuara me markën tregtare të paditësit Hugo Boss, të cilat mallra paditësi, nga fotografitë e dërguara nga Dogana e Kosovës, i ka identifikuar se nuk janë origjinale, nuk janë prodhuar nga paditësi dhe nga asnjë kompani tjetër në lidhje me paditësin. Identifikimi i tillë është bërë duke vërejtur përdorimin e gabuar të logos së paditësit, etiketës si dhe detajet e tjera të pasakta në etiketat e produkteve, gjë e cila është vërtetuar edhe nga deklaratat e paditësit.

Më tutje, ka theksuar që Dogana e Kosovës është njoftuar me kohë nga paditësi se mallrat e sekuestruara nuk janë origjinale dhe se të njëjtat duhet të shkatërrohen, mirëpo meqenëse i padituri ka pretenduar se të njëjtat janë origjinale, janë detyruar që të iniciojnë procedurën gjyqësore, ndërsa i padituri asnjëherë nuk i ka argumentuar kundërshtimet e tija të dhëna pranë Doganës së Kosovës. Në fund ka theksuar që veprimet e të paditurit – përkatësisht importimi i mallrave kontestuese, me qëllim të vendosjes në tregun e Kosovës, pa lejen dhe autorizimin e paditësit – pronarit të markës tregtare, përben shkelje të markës tregtare sipas LMT-së. I ka propozuar gjykatës, që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Gjykata lidhur me këtë çështje juridike, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datën 28.03.2024, në të cilën seancë ka qenë e pranishme përfaqësuesja e autorizuar e paditësit, ndërsa nuk ka qenë i pranishëm i padituri, i cili ftesën për seancë e shqyrtimit kryesor e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 15.03.2024, mirëpo në seancë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar andaj gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në mungesë të palës së paditur.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Certifikata për regjistrimin e markës tregtare e datës 25.08.2022 me nr. të regjistrimit 29383; Certifikata për regjistrimin e markës tregtare e datës 06.10.2022 me nr. të regjistrimit 29879; Njoftimi nga Dogana e Kosovës lidhur me kërkesën për verifikimin e mallrave i datës 05.12.2022; Vendimi me nr. të regjistrimit 8723 i datës 14.12.2012; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. KS/2018/11769 i datës 21.12.2018; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. 23458 i datës 21.06.2019; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. 23456 i datës 21.06.2019; Vendimi për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. 23457 i datës 21.06.2019; Certifikata për regjistrimin e markës tregtare me nr. 29382 i datës 25.08.2022; Letër konfirmim i datës 20.12.2022; Deklarata e paditësit e përkthyer në gjuhën shqipe e datës

23.01.2023; Komunikim elektronik i datës 13.12.2022; Shikohen fotografit e produktit të ndaluar në doganë.

Deklarimet e paditësit si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas Certifikatës për regjistrimin e markës tregtare e datës 25.08.2022 me nr. të regjistrimit 29383, Certifikatës për regjistrimin e markës tregtare e datës 06.10.2022 me nr. të regjistrimit 29879, Vendimi me nr. të regjistrimit 8723 i datës 14.12.2012, Vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. KS/2018/11769 i datës 21.12.2018, Vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. 23458 i datës 21.06.2019, Vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. 23456 i datës 21.06.2019, Vendimit për vazhdimin e regjistrimit të markës tregtare me nr. 23457 i datës 21.06.2019, Certifikatës për regjistrimin e markës tregtare me nr. 29382 i datës 25.08.2022 vërtetohet se paditësi e ka regjistruar dhe e ka vazhduar regjistrimin pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale dhe është pronar i markës tregtare verbale “HUGO BOSS”, markës tregtare verbale “HUGO HUGO BOSS”, markës tregtare verbale “BOSS HUGO BOSS”, dhe markës tregtare verbale “BOSS”, si dhe i njëjti është bartës i të drejtës së këtyre markave tregtare për produktet dhe shërbimet nga Klasa 3, 9, 14, 18, 25, 28, 34, 35 dhe 42 të Klasifikimit të Nicës.

Sipas Njoftimit nga Dogana e Kosovës lidhur me kërkesën për verifikimin e mallrave i datës 05.12.2022, vërtetohet se malli kontestues i paditurit është ndaluar nga Dogana nën dyshimin për shkelje të së drejtës së markave tregtare të paditësit. Nga fotot e prezantuara të cilat gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se mallrat kontestuese të paditurit përmbajnë shenja identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit.

Sipas Letër konfirmimit të datës 20.12.2022 dhe deklaratës së paditësit e përkthyer në gjuhën shqipe e datës 23.01.2023, është konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se produkti jakne 55 copë, të sekuestruara nga Dogana e Kosovës, nuk janë prodhuar nga paditësi dhe të njëjtat janë të falsifikuara.

Sipas komunikimit elektronik të datës 13.12.2022, është konstatuar se përmes komunikimit përmes email A.M. ka njoftuar A.H. se i padituri nuk është tërhequr nga kundërshtimi për rastin me numër 581/2022, i ndaluar në Doganën e Kosovës dhe ka informuar të njëjtin se afati i fundit për tërheqje të kundërshtimit është data 19.12.2022.

Gjykata pas shqyrtimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave së bashku, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, sepse shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markat tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit.

Sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare (LMT) i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund të ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjen identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me regjistrimin e markës tregtare. Sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta që të ndalojë përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion, të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës, si dhe të disponojë me markën tregtare të tij.

Mbajtësi i një marke tregtare sipas nenit 9 të LMT-së, ka të drejtë që të ndalojë vendosjen e markës së mbrojtur, në mallra, në paketim ose etiketat e mallit; ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e tij për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij; importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare dhe përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj, përbën shkelje të markës tregtare. Sipas nenit 9 të LMT-së, shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëri prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës rezulton si jokontestues fakti se importimi i mallrave kontestuese nga i padituri, të cilat nuk janë mallra të prodhuara nga paditësi, e në të cilat mallra është përdorur shenja identike me markat tregtare të regjistruara të paditësit, përbën shkelje të markës tregtare.

Prandaj duke u nisur nga të sipër cekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, gjykata ka konstatuar se i padituri përmes importimit të mallit: 55 palë jakne, ka shkelur markat tregtare të regjistruara të paditësit, përkatësisht markën verbale “HUGO HUGO BOSS” me numër të regjistrimit 23456, markën verbale “BOSS”, me numër të regjistrimit 23458, markën verbale “BOSS HUGO BOSS”, me numër të regjistrimit 23457, dhe markën verbale “HUGO BOSS”, me numër të regjistrimit 8723.

Vendimin për shkatërrimin e produkteve me shpenzimet e të paditurit, vendimin për publikimin e këtij aktgjykimi në mjetet e informimit, si dhe obligimin e të paditurit për dhënien e informacioneve, gjykata e morri konform dispozitave të nenit 78, 83 dhe 92 par. 5 të Ligjit Nr. 08/L-075 për Markat Tregtare i Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën VIII të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi dhe atë: për përpilimin e padisë shumë prej 208 €, për taksë gjyqësore shumë prej 120 € dhe përfaqësim në dy seanca gjyqësore shumë prej 540 € (2x270), në shumë të përgjithshme prej 868 €.

Nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.6/23, datë 11.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.